

VENDIM
Nr. 85, datë 24.4.2025

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT
QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “ALBESP TRADING &
CONSULTING” SHPK**

(Ndryshuar me vendimin nr. 111, datë 23.5.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pika 5, dhe nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1064/10 prot., datë 23.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni, si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. është e licencuar nga ERE, në:
- Veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 2.12.2021, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 2.12.2021.
- Me shkresën nr. 230 prot., datë 10.2.2025, protokolluar në ERE me nr. 1064 prot., datë 10.2.2025, shoqëria paraqiti aplikimin për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Gjatë shqyrtimit të kërkesës, u evidentuan mungesa në dokumentacionin e paraqitur. Për këtë arsye, me shkresën nr. 1064/2 prot., datë 24.2.2025, shoqërisë iu njoftua mbajtja e një seance dëgjimore, e cila u zhvillua më datë 6.3.2025, në ambientet e ERE-s, me qëllim evidentimin e informacionit dhe dokumentacionit të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Në vijim, me shkresat e dërguara nga ERE nr. 1064/4 prot., datë 13.3.2025; nr. 1064/5 prot., datë 27.3.2025; dhe nr. 1064/8 prot., datë 14.4.2025 është vijuar korrespondenca me shoqërinë, e cila ka depozituar dokumentacionin plotësues përkatës me shkresat nr. 1064/3 prot., datë 7.3.2025; nr. 1064/6 prot., datë 2.4.2025; dhe nr. 1064/7 prot., datë 14.4.2025.

- Nga verifikimi rezulton se shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera financiare ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit.

3. Vlerësime dhe kushtet për dhënie e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e nevojshme nga palë të treta, në rast se kërkohet prej tyre.

- Në referencë të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. detyrohet që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i reflektimit të ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e saj në regjistrin tregtar të QKB-së, të depozitojë pranë ERE-s ekstraktin historik të përditësuar, me qëllim sigurimin e dokumentimit zyrtar dhe të verifikueshëm të këtij ndryshimi, garantimin e informacionit të saktë dhe të përditësuar mbi kontrollin dhe strukturën e kapitalit të subjektit të licencuar, si dhe respektimin e kuadrit rregullator për detyrimet e njoftimit ndaj autoritetit rregullator.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k.

2. Ortaku i vetëm që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. bëhet z. Alfred Sadikaj.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e nevojshme nga palë të treta, në rast se kjo kërkohet.

4. *Shfuqizuar.*

5. *Shfuqizuar.*

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti